



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim kontrolli: Union Bank Sh.a – Landeslease Sh.a

Në datën 6 Tetor 2014, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës së shitblerjes së aksioneve” e nënshkruar midis palëve (Landeslease Sh.a në cilësinë e Shitësit dhe Union Bank në cilësinë e Blerësit) më datë 25 Shtator 2014, me objekt përfitimi i kontrollit të ndërmarrjes Landeslease Sh.a nga ndërmarrja Union Bank Sh.a.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Union Bank Sh.a:** është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 6 Janar 2006 dhe ushtron aktivitetin e saj në bazë të Ligjit nr. 9662, datë 18 Dhjetor 2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”
- **Landeslease Sh.a:** është një institucion financiar dhe ushtron veprimtarinë e qirasë financiare në përputhje me licencën e Bankës së Shqipërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1.b) dhe 12, pika 1) dhe 2, të Ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al